



## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJILAN,DEGA NË NOVOBËRDË-**  
**Departamenti i Përgjithshëm,** përmes gjyqtarës Emine Salihu me bashkëpunëtorin profesional Sulejman Rexhepi, në lëndën penale ndaj të akuzuarit Ç... nga fsh. Llabjan, Komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale ,Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë ,Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.557/2017 të datës 24.05.2017,të cilën e përfaqsoonte prokurorja Kujtesa Fazliu ,pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më dt.18.03.2018 në prezencë të palëve mori dhe shpalli këtë,

### AKTGJYKIM

I akuzuari Ç... me pseudonimin "Dua" nga i ati dhe e ëma Bajramshahi , e lindur ... i lindur më dt 22.02.1989,në Gjilan ndërsa tani jeton në fsh Llabjan K.Novobërdës ku edhe jeton ,ka të kryer shkollën e mesme ,i martuar , babë i një fëmijë punon si kamarier "Swiss Food" në fsh. Llabjan afër market "Bajramshahi" i gjendjes së mesme ekonomike,shqipëtar ,shtetas i Republikës së Kosovës me nr. Identifikimit ID...,,më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për ndonjë vepër tjetër penale.

### Është fajtor

Më datë 21.12.2016,në fshati Llabjan komuna Novobërdë ,gjatë kontrollës së realizuar nga zyrtaret e KEDS-it ,i pandehuri,me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme ,është hasur në shtëpinë e tij duk e shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të pa autorizuar ,në at mënyrë që ka bërë lidhje jashtë pikës matëse në mënyrë të paautorizuar dhe ka furnizuar pajisjet e evidentuara jashtë matjes ,me qëllim që të shpanzoj energjinë elektrike dhe mos të faturohet ,me ç'rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 431.64 €,-

-me këtë ka kryer veprën penale ,Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e cituara ligjore ,nenin 4,41,42,43,,49,50,51,53,73,të KPRK,si dhe nenin 365 të KPPK-ës të akuzuarin,

## **E GJYKON**

Për veprën penale të dispozitivit të aktakuzës me dënim me burgim në kohëgjatje prej 3 (tre)muajve ,i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftëse i pandehuri brenda afatit prej 1 (1)viti nuk kryen vepër tjetër penale ,në të kundërtën gjykata do t'ia revokoj dënimin me kusht .

E dëmtuara ,përfaqësuesi i ~~aktakuzuarit~~ në Prishtinë për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari ti paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzet e pesë euro)si dhe në emër të harxhimeve procedurale shumë e përlllogaritur në llogarinë përfundimtare të kësaj gjykate , të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në konform të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit i akuzuari ~~Qëndrim Fazliu~~,obligohet të paguaj taksën në shumë prej 30 euro.

## **Arsyetim**

Prokuroria Temelore në Prishtinë ,ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.557/2017 të datës 24.05.2017 ndaj të pandehurit ~~Qëndrim Fazliu~~ nga fsh. ~~Illobina~~,Komuna e Novobërdës,për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale ,nga neni 320 të të Kodit Penal të Republikës së Kosovës .

Prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu pas mbajtjes së së shqyrtimit fillestartë të datës 18.03.2019 ka deklaruar:mbes në tërësi pran aktit akuzues pasi që në shqyrtimin e sotëm fillestar i akuzuari e ka prnuar fajsinë për veprën penale e cila i vëhet në barrë ,për të cilin pranim gjykata e ka njoftuar me pasojat dhe favoret e pranimit të fajsisë .Mbi bazën e këtij pranimi dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj me dënim meritor sipas ligjit ,i cili dënim do të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale ,rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale .

I pandehuri ~~Qëndrim Fazliu~~ ka deklaruar :se aktakuzën e lexuar nga ana e prokurores të shtetit e kam kuptuar në tërësi ,e ndiej vehtënjë fajtor dhe e pranoj fajsinë ,është hera e parë që ndeshem me ligjin dhe i premtoj gjykatës se nje veprim të tillë nuk do ta përsërisë dhe kërkoj nga gjykata që të më shqyptoj një dënim sa më të butë.

Pas dëgjimit të prokurorës të shtetit dhe të akuzuarit ,gjqqtarja e vetme gjykuese konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore ,nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajsisë ,nga se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,pranimi mbështetet nga faktet e çështjes nga aktakuza e cila nuk përmban as një shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj ,duke u bazuar në këtë që u cekën më lartë ,gjqkatarja e vërtetoi gjendjen faktike :

Se i pandehuri Qëndrim Avdyli nga fsh. Ulëjan ,e ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale ,nga neni nga neni 320 të të Kodit Penal të Republikës së Kosovës .

Gjqqëtarja e vetëm gjykues , shpalli fajtor të pandehurin Qëndrim Avdyli nga fsh. Ulëjan ,Komuna e Novobërdës për veprën e cekur më lartë nga se veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastine matjes së dënimit të pandehurit gjykata ia ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ,sipas nenit 73,të KPRK-së ku si rrethanë veçanarishtë lehtësuese gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajsinë ,sjelljen korrekte në gjykatë ,ka shprehur keqëardheje për kryerjen e kësaj vepre , si dhe faktin se më parë nuk ka qenë e dënuar për ndonjë vepër tjetër penale .Ndërsa , nuk ka gjetur ndonjë rrethanë pasaqërisht rënduese.

Sipas bindjes së kësaj gjykate ,caktimi i dënimit me kusht ndaj të pandehurit Qëndrim Avdyli është dënim i drejtë ,në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit ,si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit ,nga neni 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 të KPRK-së.

Vendimi për kërkesën pasurore është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 1.2 të KPPRK-së.

Nga të cekurat si më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJKATA THEMELORE NË GJILAN ,DEGA NË NOVOBËRDË**  
**Departamenti i përgjithshëm**

**P.nr.43/2018      18.03.2018**

**Bashkëpunëtori Profesional**  
**Sulejman Rexhepi**

*S. Rexhepi*



**Gjyqtarja**  
**Emine Salihu**

*E. Salihu*

**KËSHILLA JURIDIKE** :Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në gjykatën e Apelit në Prishtinë ,në afate prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit .Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj gjykate.